



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Departamenti i Inspektimit

Inspektorati Policor i Kosovës
Polijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Nr:1/2013

**Vlerësimi i performances policore gjatë
ndërrimit të natës me 24 maj 2013, në Stacionet
Policore dhe NJTR.**



Qershor 2013

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

2. HYRJE

3. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE TË GJETURAT

3.1 Vlerësimi dhe krahasimi i kapaciteteve aktive gjatë ndërrimit të natës me 24 maj 2013

3.2 Vlerësimi i planeve të patrullave për ndërrimin e natës me 24 maj 2013 dhe vlerësimi i nivelit të sigurisë së Stacioneve Policore- Komandave Regjionale

4. PËRFUNDIMET, REKOMANDIMET DHE PLANI I VEPRIMIT

4.1 Përfundimi

4.2 Rekomandimet

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Me datë 24-maj 2013, në mes të premtes dhe të shtunës, Inspektorati Policor i Kosovës ka zhvilluar inspektim të jashtëzakonshëm lidhur me vlerësimin e performances policore gjatë ndërrimit të natës nga njësitë e Divizionit të Sigurisë Publike gjegjësisht nga Komandat Regjionale, Stacionet Policor dhe Njësitë e Trafikut Regjional.

1.2 Gjatë këtyre inspektimeve, Inspektorati Policor i Kosovës ka inspektuar gjithsej 34 stacione/njësi policore përfshi edhe gjashtë Komandat Regjionale. Kriteret e përdorura gjatë këtyre inspektimeve kanë qenë elementare, si; numri i policëve në ndërrim, numri i të graduarve, elementet bazë të sigurisë së njërive policore, elementet bazë të organizimit operativ dhe elementet bazë të organizimit administrativ.

1.3 Të gjeturat gjatë këtij inspektimi nuk ishin të kënaqshme , gjatë këtij inspektimi me 24 maj 2013 ku nga 34 stacione/njësi policore gjatë turnit të natës, nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve policor sipas strukturave organizative të këtyre njërive të inspektuara vetëm 10% e zyrtarëve policor ishin aktivë apo ne detyrë, apo nga 2960 zyrtarë policor vetëm 300 zyrtarë policor ishin aktive ne gjashtë Komanda Regjionale dhe 34 stacione/njësi policore. Ndërsa nga personeli i graduar me gradën rreshter, nga 315 rreshter vetëm 31 ishin aktive në këto njësi të inspektuara. Sa i përket vijës së mesme menaxhuese dhe vijës së lartë menaxhuese ku përfshihen gradat nga Toger e deri te Koloneli vetëm 5 Toger dhe 1 Major ishin aktiv gjatë këtij ndërrimi nga një total prej 103 Togerëve, 49 Kapitenëve, 9 Majorëve, 11 Nënkolonelëve dhe 2 Kolonelëve.

1.5 Edhe të gjeturat tjera ne aspektin e sigurisë bazë të stacioneve/njësive policore dhe elementet bazë të organizimit operativ dhe administrative nuk ishin të kënaqshme p.sh. E gjetura e përgjithshme është se gjatë inspektimit të 24 majit 2013 nga 34 stacione të inspektuara 13 stacione policore/njësi nuk kishin pasur roje të stacionit, Regjistër të hyrje-daljeve 2 stacione/njësi nuk i kishin këta regjistra, plane patrullimi nga 34 stacione/njësit- 7 nuk kishin fare plane patrullimi, librin e ankesave të qytetarëve nuk e posedonin 6 njësi të inspektuara, 9 njësi nuk posedonin raportin nga ndërrimi paraprak, 8 stacione/njësi janë vlerësuar me gjendje të keqe të sigurisë, 5 dhoma ndalimi nga këto 34 njësi të inspektuara janë vlerësuar me gjendje të keqe.

1.7 Inspektorati Policor i Kosovës duke analizuar këto të gjetura të këtij inspektimi konstaton se kjo gjendje ndikon negativisht në imazhin e policisë së Kosovës dhe Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që urgjentisht të reagoj duke aktivizuar të gjitha resurset e tij për ta ndryshuar këtë gjendje dhe duke bërë inspektime dhe auditime të shpeshta dhe duke shqiptuar masat e nevojshme disiplinore secilin që neglizhon punën e tij në kuadër të këtij institucioni kaq të rëndësishëm për sigurinë e vendit siç asht Policia e Kosovës.

2. HYRJE

2.1 Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, konform ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës neni 23 dhe 24, Inspektorati Policor i Kosovës ka zhvilluar inspektimin e jashtëzakonshëm në Divizionin e Sigurisë Publike mbi vlerësimin e performancës Policore të këtij divizioni gjatë ndërrimit të natës.

2.2 Qëllimi i këtij inspektimi të jashtëzakonshëm ka qenë që të vlerësohet dhe të konstatohet kryerja e detyrave policore gjatë ndërrimit të natës lidhur me performancën e policisë së Kosovës në ofrimin e sigurisë për qytetarët e vendit dhe në mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike.

2.3 Objektivat të cilat ka synuar t'i arrijë ky inspektim janë;

- Vlerësimi i kapaciteteve aktive gjatë turnit të natës.
- Vlerësimi i planeve të patrullave për ndërrimin e natës (a kanë planë të patrullave objektiva dhe detyra të qarta konform nevojave- specifike të rasteve, a janë të përfshira rrugët që do të mbulojnë, pikat kontrolluese, lokalet e dyshimta dhe aktive gjatë natës që do të duhej vizituar apo prioritete tjera).
- Vlerësimi i nivelit të sigurisë së Stacioneve Policore- Komandave Regjionale (Rojet, ndriçimi, evidentimi i personave që hyjnë në stacion-regjion)

2.4 Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit policor luan rol të rëndësishëm në:

- Përmirësimin dhe ngritjen e vazhdueshme të performancës së punonjësve në kuadër të Divizionit të Sigurisë Publike
- Përmirësimin e shërbimeve duke siguruar shkallë më të lartë të sigurisë për qytetarë
- Në ngritjen e profesionalizmit, disiplinës dhe përgjegjësisë së zyrtarëve policor që i janë të angazhuar në ndërrimin e natës për të qenë efektiv dhe efikas.
- Ngritjen e shkallës së sigurisë për pjesëtarët dhe pasurinë e policisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

2.5 Vlerësimi i rrezikut duhet të jetë dydimensional:

1. Rreziku apo mundësia e hasjes së menaxhimit jo efektive gjatë kohës së inspektimit llogaritet si e madhe marr parasysh informatat paraprake që kemi nga qytetarët dhe mediet lidhur me mungesën e patrullimeve dhe ndjenjën e pasigurisë që qytetarët mund të kenë.
2. Duhet të llogariten pasojat që mund të i ketë Policia e Kosovës në rast të ndonjë aksidenti apo incidenti në rast të moskujdesit për pronën dhe pasurinë e policisë të cilën e menaxhon PK-ja

2.6 Periudha e mbulimit-inspektimit ka qenë data 24 maj 2013, Ndërrimi i natës (8 orësh) në mes të premtës dhe të shtunës.

2.7 Metodologjia e përdorur gjatë këtij inspektimit ka qenë që përmes një inspektimi të jashtëzakonshëm dhe të papritur të vlerësohet preformanca e Policisë së Kosovës në 34 njësi të Divizionit të Sigurisë Publike gjatë ndërrimit të natës për të vlerësuar trendin e performancës, duke:

- Intervistuar punonjësit në ndërrimin e natës.
- Kontrolluar fizikisht i stacionet-regjionet policore, autoparkun, qendrat e ndalimit, zyrave të intervistimit dhe hapësirave tjera, si dhe
- Kontrollimi i dokumentacionit me të cilin pasqyrohet e tërë puna e këtyre njësive duke përfshirë; oraret e ndërrimit, planet e patrullave, radiolegjet, librin e ankesave, raportin nga ndërrimi paraprak, regjistrin e hyrje-daljeve në stacion.

2.8 Përbërja e grupit të inspektimit ka qenë në përbërje të Inspektorëve dhe Hetuesve nga të gjitha departamentet e IPK-së të ndarë në 14 ekipe me gjithsej 32 Inspektor/hetues. Ky inspektim është zhvilluar në tre valë; vala e parë e inspektimeve ka qenë ora 12:00-01:00 ku janë inspektuar 14 njësi nga 14 ekipe inspektorësh njëherazi, vala e dytë 02:00-03:00 gjithashtu janë inspektuar 14 njësi tjera nga 14 ekipet aktive të inspektimit dhe vala e tretë 04:00-06:00 janë inspektuar edhe 6 njësitë tjera nga ekipet inspektuese.

3. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE TË GJETURAT

3.1 Vlerësimi i kapaciteteve aktive gjatë ndërrimit të natës

3.1.1 Detyrat e përgjithshme të policisë janë të përcaktuara me ligjin për policinë të cilat janë: të mbrojt jetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat, të mbrojt të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave, të parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike, të parandaloj dhe t'i zbuloj hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre, mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion etj.

3.1.2 Përgjegjësia për sigurimin dhe ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në nivel regjional, sipas Strukturës Organizative të Policisë së Kosovës është Divizioni i Sigurisë Publike i cili shtrihet në tere territorin e Kosovës dhe ndahet në 6 Drejtori Rajonale ku përfshihen Stacionet Policore. Detyrat kryesore të këtyre Drejtorive Regjionale janë që përmes patrullimeve të rregullta dhe të planifikuara të bëhet parandalimi i krimeve, të sigurohet rendi dhe qetësia publike dhe të hetohen dhe gjurmohen aktivitetet kriminale.

3.1.3 Detyrat e njësive patrulluese janë të përcaktuara në Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të Policisë së Kosovës, P-5.10 kapitulli III, pika D (Prishtinë 2009), ku thuhet;

- Njësi Policor patrullues ekziston pikërisht për të siguruar mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës. Funkcionet e këtij shërbimi përfshijnë sa vijon por nuk kufizohen;
 - ✓ Të parandaloj paraqitjen e krimit në rrugë duke qenë gjithmonë prezent me shërbim patrullues;
 - ✓ T'u përgjigjet me efikasitet çdo rasti që urgjent kërkon intervenimin e shërbimit policor;
 - ✓ Për ngritjen e nivelit të parandalimit të krimit duke kryer hetime paraprake tërësore në vendin e ngjarjes;
 - ✓ Me zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe rregulloreve në trafik të pengojë tollovitë në trafik dhe rreziqet e ndryshme;
 - ✓ Të intervenoj në raste të fatkeqësive të komunikacionit;
 - ✓ Ti ndihmoj viktimave dhe të hulumtoj shkaqet e aksidenteve;
 - ✓ Ti ndihmoj qytetarëve rreth problemeve ligjore, shëndetësore, sociale ose humanitare, duke intervenuar vetë ose duke i orientuar qytetarët tek agjencionet apo organizatat e caktuara për probleme të tilla; dhe
 - ✓ Të përforcoj bashkëpunimin me bashkësinë duke rritur kualitetin dhe kuantitetin e patrullave të Policisë.

3.1.4 Ky Divizion në kuadër të strukturës së saj ka të gjitha gradat komanduese dhe udhëheqëse dhe ka numrin më të madh të policëve në kuadër të Policisë së Kosovës dhe është bazamenti

kryesore i saj. Shumica dërrmuese e policëve të këtij divizioni janë policë patrullues dhe vija e pare e kontaktit me qytetare, performanca e tyre është matësi kryesor i performances policore.

3.1.5 Policët e këtij divizioni janë pjesë e njësive patrulluese nga të cilët kërkohet që të punojnë me orar të punës tre ndërrimesh,“ punët e të cilëve kërkojnë aplikimin e formës së punës me katër ekipe apo skuadra të policisë”¹.

3.1.6 Inspektorati Policor gjatë këtij inspektimi të jashtëzakonshëm ka bërë krahasimin e numrit të policëve sipas strukturës organizative te stacioneve dhe regjioneve dhe numrit të policëve aktive të gjetur nga Inspektorati Policore gjatë Inspektimit të jashtëzakonshëm, krahasimin e numrit të policëve aktive gjatë ndërrimit të natës dhe numrit të banorëve të cilat i mbulon njësia e caktuar dhe numrit të policëve dhe kilometrave katror të cilat i mbulon njësia e caktuar.

3.1.7 Inspektorati Policor gjatë këtij inspektimi të jashtëzakonshëm ka gjetur këtë gjendje për sa i përket numrit të policëve aktiv neper stacione policore gjatë ndërrimit të natës në mes të premtës dhe të shtunës me 24 maj 2013, e paraqitur ne tabelën nr 1.

3.1.8 Në këtë tabelë do të gjeni numrin e policëve sipas strukturës organizative në 34 stacione policore të inspektuara gjatë kësaj nate, numrin e policëve të gjetur në ndërrimin e natës 24 maj - në mes të premtës dhe të shtunës- në këto 34 stacione/njësi. Do të gjeni numrin e banorëve dhe kilometrat katror për secilën njësi dhe krahasimin në mes të numrit të policëve për kokë banori dhe numrin e policëve për kilometra katrorë.

3.1.9 Në kuadër të këtyre të gjeturave do të gjeni vetëm stacionet e inspektuara dhe vetëm të dhënat e këtyre stacioneve pa përfshirë nënstacionet e ndryshme në kuadër të nënndarjeve tjera organizative të strukturave të stacioneve. Sidoqoftë stacionet e inspektuara janë ato stacione të cilat janë të përqendruara në qendrat kryesore administrative të cilat kanë numrin më të madh të banorëve dhe hapësirën më të madhe për të mbuluar.

¹Doracaku i Parimeve dhe Procedurave (dhjetor 2009) P-3.14, (IV.A,B), Faq 132

Tabela nr 1

Numri dhe përqindja e policëve aktiv gjatë ndërrimit të natës ne stacionet policore me 24 maj 2013 dhe krahasimi i numrit te banorëve dhe kilometrave katror për policë								
	Stacioni/ Njësia	Nr. i Policëv e sipas strukturu rës ²	Numri i policëve në ndërrimi n e natës ³	% aktive e policëve në ndërrimin e natës ⁴	Nr. i banorëve për stacion ⁵	Nr. i policëve në ndërrimin e natës për kokë banori ⁶	Km ² në përgjegjësi të stacionit ⁷	Numri i policëve në ndërrimin e natës për km ² ⁸
DRP FERIZAJ								
1	FERIZAJ	120	7	6%	108 690	1/15527	345	1/49
2	KAÇANIK	50	3	6%	33 454	1/11151	291	1/97
3	SHTIME	46	7	15%	27 288	1/3898	134	1/19
4	SHTËRPC	54	6	11%	6 919	1/1153	247	1/41
5	NJTR	53	4	7.5%	P/A	P/A	1017	1/254
DRP GJILAN								
6	GJILAN	136	14	10%	90 015	1/6430	349	1/25
7	KAMENICË	76	10	13%	35 600	1/3560	523	1/52
8	VITI	67	6	9%	46 959	1/7826	300	1/50
9	NOVOBERD	32	4	12%	6 720	1/1680	204	1/51
10	NJTR	59	5	8.5%	P/A	P/A	1505	1/301
DRP MITROVICË								
11	JUGUT	144	13	9 %	71 601	1/5508	331	1/25
12	VUSHTRRI	138	10	7 %	69 881	1/69881	345	1/35
13	SKENDERAJ	117	10	8.5%	51 317	1/5132	374	1/37
14	NJTR	77	10	12 %	P/A	P/A	2048	1/205
DRP PEJË								
15	PEJË	109	9	8 %	95 723	1/10636	603	1/67
16	GJAKOVË	94	6	6 %	94 158	1/15693	586	1/98
17	ISTOG	67	6	9%	39 294	1/6549	454	1/76
18	DEQAN	50	3	6 %	38 984	1/12995	371	1/124
19	JUNIK	23	3	13 %	6 078	1/2026	77	1/26
20	NJTR	87	6	7%	P/A	P/A	2 399	1/400

² ZP ne Stacionet Policore dhe NJRT, DRP Ferizaj, email e mërkurë 2013-05-29 11:05 PD, DRP Gjilan email e martë 2013-05-28 12:48 MD, DRP Mitrovicë email e mërkurë 2013-05-29 10:47 PD, DRP Pejë email e mërkurë 2013-05-29 11:22 PD, DRP Prishtinë email e martë 2013-05-28 4:48 MD, DRP Prizren e martë 2013-05-28 10:53 PD.

³ Te gjeturat e Inspektoratit nga terreni gjate Inspektimit te Jashtëzakonshëm datë 25.05.13

⁴ Krahasime e numrit te policëve ne njësit policor te inspektuara dhe numrit te policëve ne ndërrimin e natës

⁵ Numri i banorëve është marr nga Enti i Statistikave te Kosovës- nga rezultatet paraprake te regjistrimit te popullsisë me 2011 ne Kosovë- REKOS 2011- <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/>

⁶ Krahasim i numrit te policëve ne ndërrimin e natës dhe numrit të banorëve për komunë te cilën e mbulon njësia.

⁷ Kilometrat katror për secilin Stacion Policor , Shef i Stafit të Drejtorit të Përgjithshëm Policia e Kosovës, email -Tuesday, May 29, 2012 3:06 PM; Vërejtje- numri i kilometrave katror nga kjo e dhenë nuk përputhet me totalin e kilometrave të Kosovës për 326 km, janë më shume.

⁸ Krahasim i numrit te policëve ne ndërrimin e natës dhe numrit të kilometrave katror te cilën e mbulon njësia.

DRP PRISHTINË								
21	QENDRA	173	12	7%	198 214	1/3812	13	1/1.1
22	VERIU	132	20	15 %	198 214	Totali i policëve nga tre stacionet	328	1/16
23	JUGUT	174	20	11 %	198 214		44	1/2
24	PODUJEVË	87	8	9%	87 933		1/10992	630
25	GLOGOC	88	9	10%	58 579	1/6509	275	1/31
26	GRAÇANIC	44	10	22%	11 006	1/1101	300	1/30
27	F. KOSOVË	64	6	9%	34 718	1/5786	101	1/17
28	LIPJAN	72	10	13%	57 474	5747	422	1/42
29	NJTR	128	11	8.5%	P/A	P/A	2218	1/202
DRP PRIZREN								
30	PRIZREN	138	16	11.5 %	178 112	1/11132	608	1/38
31	SUHAREKË	78	14	17 %	59 702	1/4264	361	1/26
32	RAHOVEC	54	8	14 %	55 053	1/6882	282	1/35
33	MALISHEVË	65	7	11%	54 664	1/7809	306	1/44
34	NJTR	64	7	11%	P/A	P/A	2024	1/289
TOTALI		2960	300	10%	1.618.136	1/5394	10 884	1/ 36

3.1.10 Siç shihet edhe nga kjo tabelë numri i zyrtarëve policorë të angazhuar gjatë ndërrimit të natës të datës 24 maj 2013 ishte jashtëzakonisht i vogël dhe jo i mjaftueshëm për të zbatuar detyrat dhe përgjegjësit me të cilat ata janë të angazhuar.

3.1.11 Sipas këtyre të gjeturave në 34 stacione policore, mesatarja e policëve në ndërrim të natës në maj të vitit 2013 ishte vetëm 10.% e fuqisë policore të përcaktuar sipas strukturës. Nëse kjo krahasohet me numrin e banorëve për mbrojtjen dhe sigurinë e të cilëve janë përgjegjës këta polici bie se 1 policë kishte përgjegjësinë që të kujdesej për 5394 banorë e cila nuk i plotëson kushtet për një siguri për qytetarët e vendit. Nëse kësaj i shtohet edhe fakti se çdo patrullë policore përbëhet nga dy policë kjo tregon se kjo shifër e banorëve për policë do të dyfishohet.

3.1.12 Si e gjetur tjetër nga kjo tabelë del edhe kilometrat katrorë të cilat duhet ti mbuloj një polic. Sipas krahasimeve tona, mesatarja e kilometrave katrorë të cilat ishte dashur ti mbulonte një policë në natën e 24 majit 2013- *mes të premtës dhe të shtunës*- ishte një polic për 36 kilometra katror. Edhe në këtë rast fakti se një patrullë mbulohet nga dy polic edhe kjo shifër dyfishohet duke arritur 72 kilometra katror që nëse këtë e përkthejmë në minuta i bie se nëse udhëtohet me shpejtësi prej 100 km në orë, e cila nuk është e lejuar në shumicën e rrugëve të Republikës së Kosovës, 72 kilometra kalohen për rreth 43 minuta, kohe kjo mjaft e madhe për ti ardhur ne ndihme një qytetari që mund të jetë viktime e ndonjë akti kriminal pa përfshi këtu aspektin e preventives .

3.1.13 Inspektorati Policor i Kosovës konkludon se gjendja e gjetur nga ky inspektim i jashtëzakonshëm nuk është e kënaqshme, është në kundërshtim me parimin P-3.14 Orarin e Punës së zyrtarëve policor te angazhuar në patrullë dhe në kundërshtim me parimin 3.10 të Patrullimit me të cilat punon Policia e Kosovës.

Rekomandimi nr 1.

Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Regjionale lidhur me kapacitetet njerëzore të angazhuara gjatë ndërrimit të natës dhe të ndërmarr masa disiplinore ndaj Udhëheqësve të njësive përbërëse të tyre të cilët neglizhojnë parimet dhe procedurat e Policisë së Kosovës.

3.1.14 Inspektorati Policor i Kosovës, gjatë këtyre inspektimeve ka gjetur se edhe performanca e personelit të graduar të cilët duhet të jenë bartësit kryesorë dhe shembujt e policimit të mirë në natën e 24 majit 2013 nuk ishte në nivelin e dëshiruar duke parë se numri i personelit të graduar aktivë gjatë ndërrimit të natës ishte minimal.

3.1.15 Sipas parimeve dhe procedurave të Policisë së Kosovës, gjegjësisht parimit P-3.31, 3.32, 3.33, 3.34, 3.36, 3.37, ku përshkruhen detyrat dhe përgjegjësitë nga grada e rreshterit e deri te grada e kolonelit, pika e përgjegjësisë, përgjithësisht tek të gjithë, ku thuhet se; grada e caktuar duhet t'u ofroj ndihmë menaxhuese udhëheqësve më të ulët dhe të sigurojë se të gjitha kërkesat operacionale dhe administrative realizohen në mënyrë profesionale dhe efikase.

3.1.16 Gjatë analizimit të të dhënave, Inspektorati Policor ka gjetur se edhe pse kishte një numër të mjaftueshëm të personelit të graduar sipas strukturës organizative ata në shumicën e stacioneve policore si "Udhëheqës të ndërrimit" kishin Oficer Policor i cili nuk posedon trajnimin e duhur për të menaxhuar me një ndërrim dhe është i barabartë edhe nga trajnimet edhe nga grada me kolegët e tjerë Oficer Policor. Investimet të cilat ka bërë Policia e Kosovës në trajnime dhe përgatitje të personelit të graduar ka qenë me qëllimin që ata të jenë shembujt dhe përkrahje për policët tjerë. Personeli i graduar natën e inspektimit përgjithësisht nuk ishin aktiv gjendej kjo që do të ilustruhet më konkretisht në tabelën nr 2.

3.1.17 Siç do të shihet nga tabela nr 2, nga 315 rreshter policor që kanë gjashtë Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës vetëm 31 rreshter kanë qenë aktivë në 34 stacione/njësi policore përfshirë edhe Komandat Regjionale në inspektimin e 24 majit 2013. Me gradën toger gjatë natës së 24 majit 2013 nga 103 toger në 6 Drejtori Regjionale dhe 34 Stacione Policore në detyrë kanë qenë vetëm 5 toger dhe një major; 3 toger në Prishtinë, 1 në Pejë dhe një në Gjiçan kurse me gradën e majorit që ishte në detyrë në ndërrimin e natës, ishte në Prishtinë.

Rekomandimi nr 2.

Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Regjionale lidhur me kapacitetet Udhëheqëse- Gradave të angazhuara gjatë ndërrimeve të natës dhe të ndërmarr masa disiplinore ndaj Udhëheqësve të të gjitha niveleve të cilët neglizhojnë parimet dhe procedurat e Policisë së Kosovës.

Tabela nr 2;

Numri i personelit te graduar te cilët kanë qenë aktivë gjatë natës së inspektimit ne 34 njësit e inspektuara dhe komandat regjionale																		
	Rreshter			Toger			Kapiten			Major			Nënkolonel			Kolonel		
	Totali ⁹	Aktiv	Pasive	Totali	Aktive	Pasive	Totali	Aktive	Pasive	Totali	Aktive	Pasive	Totali	Aktive	Pasive	Totali	Aktive	Pasive
DRP-Prishtine	77	10	67	25	3	22	11	0	11	4	1	3	1	0	1	/	/	/
DRP-Mitrovica	35	2	33	13	0	13	7	0	7	1	0	1	2	0	2	/	/	/
DRP-Peje	59	3	56	21	1	20	8	0	8	0	0	0	2	0	2	1	0	1
DRP-Prizren	71	8	63	13	0	13	9	0	9	3	0	3	3	0	3	/	/	/
DRP-Gjilan	45	5	40	22	1	21	7	0	7	1	0	1	2	0	2	1	0	1
DRP-Ferizaj	28	3	25	9	0	9	7	0	7	/	/	/	1	0	1	/	/	/
TOTALI	315	31	284	103	5	98	49	0	49	9	1	8	11	0	11	2	0	2

⁹ Totali I gradave është nxjerr nga Raporti Javor i Policisë së Kosovës “Personali sipas gradave” me datë 29.05.2013 ndërsa shifrat Aktiv dhe Pasive janë rezultate nga inspektimi për 2013

3.2 Vlerësimi i planeve të patrullave për ndërrimin e natës dhe vlerësimi i nivelit të sigurisë së Stacioneve Policore- Komandave Regjionale

3.2.1 Inspektorati Policor i Kosovës gjatë këtij inspektimi ka inspektuar edhe një mori pikash të cilat janë themelore për një shërbim efikas ndaj qytetarëve dhe ndaj shtetit të Republikës së Kosovës. Si pika të cilat janë kontrolluar edhe fizikisht nga Inspektorati Policor i Kosovës kanë qenë; Prezenca e rojës së stacionit, Regjistri i hyrje-daljeve, Oraret e ndërrimeve, Radiologet, Librat e ankesave, Raportet nga ndërrimet paraprake, Vlerësimi i sigurisë së objekteve policore, Vlerësimi i qendrave të ndalimit. Në paragrafët vijues do të paraqesim të gjeturat për secilën pikë veç e veç duke shpjeguar kriteret e vlerësimit dhe të gjeturat dhe do të paraqesim të gjeturat edhe në formë tabelore në tabelën nr 3.

3.2.2 Roja e stacionit është elementi bazë i sigurisë së një stacioni policor i cili ka për detyrë që të kujdeset për sigurinë e gjithëmbarshme të njësisë në të cilin ai shërben dhe ai duhet të kujdeset për regjistrin e hyrje-daljeve në stacion duke u përkujdesur që siguria e njësisë mos të vihet në pyetje asnjëherë. Kriteri i vlerësimit gjatë këtij inspektimi ka qenë vetëm të konfirmohet prezenca e rojës së stacionit me po ose jo. E gjetura e përgjithshme nga inspektimi i 24 majit 2013 në 34 stacione të inspektuara ishte; 21 stacione policore/njësi kishin pasur roje të stacionit ndërsa 13 jo. Njësitë të cilat nuk kishin roje stacioni ishin: NJTR Prishtinë, Stacioni Kaçanik, Stacioni Malishevë, Stacioni Rahovec, NJTR Prizren, Stacioni Vushtrri, Stacioni Junik, Stacioni Deçan, NJTR Pejë, Stacioni Kamenicë, Stacioni Viti, Stacioni Novobërdë, NJTR Gjilan.

3.2.3 Regjistri i hyrje-daljeve është evidenca themelore e cila shërben për të identifikuar të gjithë ata të cilët në një mënyrë apo tjetër kanë pasur qasje në objektet e njësive policore dhe arsyen e vizitës. Siç dihet qasja në ambientet e policisë duhet të jetë e kufizuar duke marrë parasysh ndjeshmërinë e punës policore. Kriteri vlerësues gjatë këtij inspektimi ka qenë që të vërtetohet fizikisht se a ekzistojnë këta Regjistra të hyrje-daljeve apo jo. E gjetura e përgjithshme nga inspektimi i 24 majit 2013 në 34 stacione, 32 stacione kishin këto regjistra ndërsa 2 nuk i kishin këto regjistra. Njësitë të cilat nuk kishin këto regjistra ishin; NJTR Pejë dhe NJTR Gjilan.

3.2.4 Oraret e ndërrimeve janë mekanizma të cilët udhëheqësit përdorin për të organizuar burimet e veta njerëzore për punë duke u kujdesur që të drejtat e tyre të punës të respektohen si dhe objektivat organizative të arrihen. Kriteri vlerësues edhe në këtë pikë ka qenë i thjeshtë, vetëm të konfirmohet se a kanë orare zyrtare të ndërrimeve apo jo, nga 34 stacionet e inspektuara të gjitha kanë pasur këtë orar.

3.2.4 Planet e patrullave ndërlidhën drejtpërsëdrejti me parimin P-5.10 Patrullimi, parim ky i cili rregullon punën e njësive patrulluese dhe si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësve dhe personelit tjetër të këtyre njësive. Ky parim parasheh formën e veprimtimit dhe rrethanat

operative të planifikimit të detyrave dhe përgjegjësive të njësive patrulluese të cilat duhet të mishërohen në një planë të patrullave për secilën njësi. Kriteri vlerësues edhe për këtë pikë ka qenë i thjeshtë që vetëm të vlerësohet se a kanë njësitet patrulluese plane të cilat i udhëheqin zyrtarët policorë në detyrë që detyrat e veta ti kryejnë në bazë të një planifikimi paraprak operativ. Të gjeturat nga terreni gjatë këtij inspektimi nuk ishin të kënaqshme, nga inspektimi i 24 majit 2013 në 34 njësi/stacione policore të cilat e kanë për detyrë patrullimin vetëm 27 stacione/njësi kishin plane të tilla kurse 7 stacione/njësi nuk kishin fare plane patrullimi. Njësitë të cilat nuk kishin këto plane të patrullimit ishin; Stacioni Graçanicë, Stacioni Jugu Mitrovicë, Stacioni Pejë, NJTR Pejë, Stacioni Gjakovë, Stacioni Novobërdë, NJTR Gjilan.

3.2.5 Radiologet janë evidenca të komunikimit të patrullave, ato janë sistemi nervor i këtyre njësive, aty evidentohen të gjitha komunikimet zyrtare të zyrtarëve në terren. Kriteri vlerësues edhe në këtë pikë ka qenë vetëm konfirmimi i mbajtjes apo jo mbajtjes së kësaj evidence aq të rëndësishme të punës policore. Edhe në këtë pikë, nga inspektimi i 24 majit 2013, Inspektorati Policor i Kosovës ka gjetur se 3 nga këto 34 njësi nuk kanë pasur fare radiolog. Njësitë të cilat nuk kanë pasur radiolog ishin; Stacioni Shtërpcë, Stacioni Novobërdë dhe NJTR Ferizaj.

3.2.6 Libri i ankesave është instrument zyrtarë të cilin duhet ta kenë çdo njësi policore për të evidentuar ankesat e supozuara të cilat i kanë qytetarët e Kosovës për të cilët punon dhe paguhet Polica e Kosovës. Edhe në këtë pikë kriteri vlerësues ka qenë mbajtja apo jo e këtij libri gjatë ndërrimit të natës, pasi ky libër duhet të jetë në posedim 24 orë për të gjitha ndërrimet. E gjetura, nga inspektimi i 24 majit 2013, në këtë pikë ishte se nga 34 njësitë/stacionet 28 kishin këtë libër kurse 6 nuk posedoni këtë libër. Njësitë të cilat nuk kishin librin e ankesave ishin; Stacioni Qendra Prishtinë, Stacioni Veriu Prishtinë, Stacioni Graçenica, Stacioni Podujeva, Stacioni Jugu Mitrovicë, Stacioni Vushtri.

3.2.7 Raporti nga ndërrimi paraprak është dokumentim i gjendjes së më hershme apo e ndërrimit paraprak i cili kërkon vazhdueshmëri nga ndërrimi tjetër për të qenë i informuar dhe për të vazhduar me punë aty ku ka mbetur ndërrimi paraprak me planifikim të mbështetur në situatën pararendëse. Kriteri vlerësues ishte; posedojnë ose nuk posedojnë raportin e ndërrimit paraprak. E gjetura nga inspektimi i 24 majit 2013 nga 34 stacione/njësi të inspektuara 25 kishin këtë raport ndërsa 9 nuk kishin në dispozicion këtë raport nga ndërrimi paraprak. Stacionet të cilat nuk kishin një raport nga ndërrimi paraprak ishin; Stacioni Qendra Prishtinë, Stacioni Veriu Prishtinë, Stacioni Lipjan, NJTR Prishtinë, Stacioni Suhareka, NJTR Prizren, Stacioni Pejë, Stacioni Skenderaj, Stacioni Novobërdë.

3.2.8 Siguria e objektit ku ishin të vendosura stacionet/njësitë policore, përveç rojës së stacionit duhet të kenë në konsideratë edhe një mori faktorësh tjerë të cilët ndikojnë në sigurinë e personelit, pronës dhe dëshmime të Policisë së Kosovës. Kriteret vlerësuese edhe në këtë pikë kanë qenë të natyrës elementare si ndriçimi përreth stacionit/njesisë, dritaret e përforcuara me grila, rrethojat e objektit, pozita e objektit, lehtësia e qasjes së pakontrolluar. Vlerësimet e

inspektoratit policore janë ndarë në tri nivele të sigurisë; mire, mjaftueshëm dhe keq. Këto vlerësime nuk kanë qenë të detajuara por japin tregues për gjendjen e përgjithshme të sigurisë së këtyre objekteve tregojnë se ku duhet të ketë një rivlerësim nga Policia e Kosovës.

3.2.9 Te gjeturat nga inspektimi i 24 majit 2013 në këtë pikë janë se nga 34 stacione /njësi 14 janë vlerësuar në gjendje të mirë të sigurisë 12 në gjendje mesatare të sigurisë ndërsa 8 në gjendje të keqe të sigurisë. Me gjendje të keqe të sigurisë ishin vlerësuar këto njësi; Stacioni Jugu Prishtinë, NJTR Prishtinë, Stacioni Lipjan, Stacioni Skenderaj, Stacioni Malishevë, Stacioni Rahovec, Stacioni Viti.

3.2.10 Qendrat e Ndalimit janë pika të ndjeshme ku policia mbanë qytetarët e privuar nga liria dhe si të tilla kanë një ndjeshmëri të lartë ku rreziku i ikjes së të arrestuarve apo edhe abuzimit me të liritë dhe të drejtat e njeriut nga zyrtarët policor është i lartë. Si i tillë Inspektorati Policor ka vendosur që në kuadër të këtij inspektimi të jashtëzakonshëm dhe të limituar në kohë të bëjë një inspektim elementar edhe të këtyre Qendrave të Ndalimit. Si kriteret vlerësimi janë përdorur prezenca e zyrtarit përgjegjës për Qendrën e Ndalimit, mirëmbajtja fizike e këtyre qendrave të ndalimit, siguria e tyre, lehtësia e qasjes në këto hapësira. Nga inspektimi i 24 majit 2013 ne 34 stacione/njësi vetëm 20 prej tyre posedonin Qendra të Ndalimit ndërsa prej tyre 10 janë vlerësuar se janë në gjendje të mirë, 5 mjaftueshëm ndërsa 5 janë konsideruar se janë në gjendje të keqe. Njësitë së janë vlerësuar me gjendje të keqe ishin; Stacioni Shtime, Stacioni Kaçanik, Stacioni Skenderaj, Stacioni Kamenicë dhe Stacioni Viti.

Rekomandimi nr 3.

Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Regionale lidhur me elementet bazë të sigurisë së objekteve policore, patrullimit si planet e patrullave dhe oraret e tyre, komunikimin dhe mjetet për sigurimin e të drejtave të njeriut si libri i ankesave dhe gjendja e dhomës së ndalimit ne baza rutinore dhe ne ndërrime të ndryshme me qëllim të përmirësimit të gjendjes duke marr masa disiplinore pa kompromis ndaj secilit që dështon ne këto kriteret bazë të policimit.

Rezultatet e pikave te inspektuara gjatë inspektimit të jashtëzakonshëm me 24 maj 2013

Pikat e vlerësimit A keni....		Roje te Stacionit		Regjistër te Hyrje-Daljeve		Oraret e ndërrimeve		Planet e Patrullave		Radiologet		Libri i Ankesave		Raporti nga ndërrimi paraprak		Siguria e Objektivit			Gjendja qendrave ndalimit		
Drejtoria Regionale të Policisë së Kosovës	Numri i Stacioneve te Inspektuara	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Mire	Mjaftueshëm	Keq	Mire	Mjaftueshëm	Keq
		DRP-Prishtine	9	8	1	9	0	9	0	8	1	9	0	5	4	5	4	4	2	3	2
DRP-Mitrovice	4	3	1	4	0	4	0	3	1	4	0	2	2	3	1	0	3	1	2	0	1
DRP-Peje	6	3	3	5	1	6	0	3	3	6	0	6	0	5	1	2	4	0	3	1	0
DRP-Prizren	5	2	3	5	0	5	0	5	0	5	0	5	0	3	2	2	1	2	1	2	0
DRP-Gjilan	5	1	4	4	1	5	0	3	2	4	1	5	0	4	1	2	1	2	1	0	2
DRP-Ferizaj	5	4	1	5	0	5	0	5	0	3	2	5	0	5	0	4	1	0	1	0	2
Totali	34	21	13	32	2	34	0	27	7	31	3	28	6	25	9	14	12	8	10	5	5

4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

4.1 Përfundim

4.1.1 Siç e cekëm edhe më lartë, qëllimi i këtij inspektimi të jashtëzakonshëm është që të vlerësohet dhe të konstatohet kryerja e detyrave policore gjatë ndërrimit të natës lidhur me performancën e Policisë së Kosovës në ofrimin e sigurisë për qytetarët e vendit dhe në mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike duke vlerësuar disa pika bazë të performancës policore.

4.1.2 Inspektorati Policor i Kosovës konsideron se sipas të gjeturave të sajë gjatë natës së inspektimit është së Policia e Kosovës gjegjësisht Divizioni i Sigurisë Publike me gjashtë Drejtorit Regjionale të sajë kishte një performance jo te kënaqshme në fushat e inspektuara.

4.1.3 Dobësitë e gjetura ndërlidhen me një dështim në menxhmentin e saj të cilët kanë dëshmuar një neglizhencë në zbatimin e rekomandimeve të IPK-së dhe parimeve dhe procedurave mbi patrullimin dhe oraret e tyre ku sipas të gjeturave kemi hasur në një numër shumë të vogël të zyrtarëve policor të graduar dhe të pa graduar të cilët ishin të angazhuar në ndërrimin e natës, në natë e inspektimit. Ajo që ishte më së shumti brengosëse ishte mungesa aq e madhe e personelit të graduar të cilët janë të obliguar dhe përgjegjës për të mos lejuar një gjendje të tillë.

4.1.4 Kjo neglizhencë dhe jo profesionalizëm gjatë natës së inspektimit ka vënë në rrezik qytetarët e Kosovës të cilët gjatë asaj nate kanë mundur të jenë viktimat të krimit apo ndonjë aksidenti apo incidenti të çfarëdo natyre. Kapacitete njerëzore të angazhuara atë natë ishin të pamjaftueshme sa që jo vetëm që nuk kanë qenë në gjendje që të siguronin qytetarët e vendit nga krimi por ato nuk kanë qenë në nivelin e duhur dhe kanë rrezikuar edhe pronën dhe sigurinë e vet zyrtarëve policore.

4.1.5 Ato kapacitet njerëzore që ishin atë natë nuk ishin të organizuara ashtu siç kërkohet me parimet dhe procedurat dhe rregullat tjera të policimit duke pasur lëshime si në aspektin operativ po ashtu edhe në aspektin administrative.

4.1.6 Inspektorati Policor potencon se një gjendje e tillë nuk duhet të tolerohet por kjo gjendje duhet të ndryshoj sa më shpejt duke përsëritur rekomandimet nga viti i kaluar drejtuar Drejtorit të Policisë që sa më shpejt të ndërmerr masa ndaj këtyre lëshimeve duke vënë në funksion inspektime dhe auditive të shpeshta në këtë divizion, të rregullta dhe të jashtëzakonshme, dhe duke ndërmarr masat e duhura disiplinore ndaj çdo shkelje që mund të haset.

4.1.7 Inspektorati Policor i Kosovës i merr shumë seriozisht këto të gjetura dhe ne të ardhmen do të organizoj edhe inspektime tjera të kësaj fushe të cilat do të jenë edhe më të detajuara dhe më të fokusuar në burimet e këtyre problemeve, në menaxhimin e këtyre njësive aq të rëndësishme për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike për qytetarët dhe shtetin e Kosovës si dhe ne implementimin e rekomandimeve të dhëna.

4.2 Rekomandime

1. *Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Regjionale lidhur me kapacitetet njerëzore të angazhuara gjatë ndërrimit të natës dhe të ndërmarr masa disiplinore ndaj Udhëheqësve të njësisë përbërëse të tyre të cilët neglizhojnë parimet dhe procedurat e Policisë së Kosovës.*
2. *Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Regjionale lidhur me kapacitetet Udhëheqëse- Gradave të angazhuara gjatë ndërrimeve të natës dhe të ndërmarr masa disiplinore ndaj Udhëheqësve të të gjitha niveleve të cilët neglizhojnë parimet dhe procedurat e Policisë së Kosovës.*
3. *Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Regjionale lidhur me elementet bazë të sigurisë së objekteve policore, patrullimit si planet e patrullave dhe oraret e tyre, komunikimin dhe mjetet për sigurimin e të drejtave të njeriut si libri i ankesave dhe gjendja e dhomës së ndalimit ne baza rutinore dhe ne ndërrime të ndryshme me qëllim të përmirësimit të gjendjes duke marr masa disiplinore pa kompromis ndaj secilit që dështon ne këto kritere bazë të policimit.*